



NJOFTIM PËR KONTRATË

Kontratë Shërbimi Procedurë e hapur

Në përputhje me nenin 6 “Procedura e hapur” dhe nenin 25 “Specifikimet teknike”, paragrafi 3 të “Rregullës së Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Shtator 2021)”

Data: 26.11.2024

Nr. i Prokurimit: BQK 24 065 221

I EMRI DHE ADRESA

Emri zyrtar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	
Adresa: Rr. Garibaldi 33, 10000 Prishtinë	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): www.bqk-kos.org	
Kontakt: Divizioni i prokurimit dhe kontraktimit	E-mail: prokurimi@bqk-kos.org
Telefoni: 038 222 055/452	Fax: 038 243 763

II LËNDA E KONTRATËS

II.1 PËRSHKRIMI

Titulli i kontratës: “Licenca dhe shërbime nga Microsoft 365 Business Premium”
Lloji i prokurimit: Shërbim
Vendi kryesor i realizimit: BQK
Informacione të marrëveshje afatgjatë (nëse aplikohen): Kontratë shërbimi me afat 1 (një) vjeçar.
Variantet pranohen: Jo
Vlera e parashikuar e kontratës: 80,000.00 euro

Ndarja në Pjesë:

JO

III INFORMACIONE PËR SHERBIMIN

Qëllimi i kësaj kontratë është të përzgjedhet kontraktuesi i cili do të realizoj në mënyrë profesionale licenca dhe shërbime nga Microsoft 365 Business Premium, sipas karakteristikave teknike dhe funksionale të përshkruara në dosjen e këtij tenderi. Për më tepër informata rreth specifikimeve teknike, ofertuesit e interesuar do të njoftohen përmes Dosjes së Tenderit e cila do t'u shpërndahet në bazë kërkesave që vijnë prej tyre.

IV KRITERET E PËRZGJEDHJES¹/KUSHTET E OBLIGUESHME PËR PJESËMARRJE

Të gjitha kompanitë (operatorët ekonomik) e interesuara janë të obliguara që t'i dorëzojnë së bashku me tenderët e tyre dokumentet për përshtatshmëri siç kërkohet këtu në vijim:

<i>Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik – Kjo kategori e dokumenteve (kërkesat 1, 2 dhe 3 në rast se aplikohet) është e obligueshme në dorëzim me ofertë dhe se nuk mund të plotësohet dhe/ose sqarohet pas dorëzimit të ofertës!</i>	<u>Kërkesa 1:</u> Deklarata nën betim se ofertuesi përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë.
	<u>Evidenca 1:</u> Deklaratë nën betim e plotësuar dhe nënshkruar duke përdorur formën në “Aneksin 3” të dosjes së tenderit.
	<u>Kërkesa 2:</u> Formulari i tenderit në formën standarde siç gjendet në Dosjen e tenderit, Pjesa C, përfshirë “Deklaratën e ofertuesve”
	<u>Evidenca 2:</u> Formulari i tenderit duhet të plotësohet me informatat siç kërkohen në formular (identifikimi i ofertuesit, çmimi me numra dhe fjalë, periudha e vlefshmërisë së ofertës, etj.) dhe duhet të nënshkruhet dhe vuloset.
	Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/ konzorcium, të gjithë anëtarët e grupit duhet të sigurojnë dëshmi mbi pranueshmërinë e tyre sipas kërkesave të listuara në pikat 1, 2 dhe 3.
	<u>Kërkesa 3:</u> Marrëveshja mbi krijimin e grupit/konzorciumit (Kjo kërkesë aplikohet vetëm në rast se oferta dorëzohet nga një grup/konzorcium)
	<u>Evidenca 3:</u> Nëse një tender dorëzohet nga një grup i ofertuesve, nga grupi kërkohet që së bashku me tenderin të dorëzojnë edhe marrëveshjen e nënshkruar në origjinal për krijimin e grupit. Të gjithë anëtarët e grupit në fjalë janë së bashku dhe veçmas të përgjegjshëm para ofertuesit për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe nëse kontrata përkatëse i ipet grupit në fjalë, ata gjithashtu

¹ Sipas nenit 27 të Rregullës së prokurimit në BQK “Kriteret e përzgjedhjes”

	<p>janë së bashku dhe veçmas të përgjegjshëm për ekzekutimin e kontratës në fjalë. Në marrëveshjen e grupit kërkohet të specifikohet lideri i grupit.</p>
<p><i>Kërkesat mbi përshtatshmërinë profesionale – Për këtë kategori të dokumenteve (kërkesat 4, 5 dhe 6) mund të kërkohen dokumentacion plotësues ose sqarime</i></p>	<p><u>Kërkesa 4:</u> Dëshmi nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se ofertuesi në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.</p> <p><u>Evidenca 4:</u> Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p> <p><u>Kërkesa 5:</u> Regjistrimi si ofertues në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit.</p> <p><u>Evidenca 5:</u> Kopja e certifikatës së regjistrimit me informatat mbi biznesin.</p> <p><u>Kërkesa 6:</u> Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë të lëshuar nga Gjykata.</p> <p><u>Evidenca 6:</u> Vërtetim nga Gjykata për Çështje Ekonomike i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p>
	<p>Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/ konzorcium, të gjithë anëtarët e këtij grupi duhet të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre sipas kërkesave 4, 5 dhe 6.</p>
<p>Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare</p>	<p>Nuk aplikohen</p>
<p>Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale – Për këtë kategori të</p>	<p><u>Kërkesa 7:</u> Ofertuesi duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku dy kontrata të natyrës së ngjashme përgjatë 3 (tri) viteve të fundit (2021, 2022 dhe 2023, përfshirë 2024 deri në shpalljen e këtij tenderi)</p> <p><u>Evidenca 7:</u> Ofertuesi duhet të ofrojë si dëshmi:</p> <p>a) certifikatat relevante të pranimit të shërbimit ose referencat që</p>

<p>dokumenteve (kërkesat 7, e 8 dhe 9) mund të kërkohen dokumentacion plotësues ose sqarime</p>	<p>evidentojnë realizimin e shërbimit të tillë, dhe</p> <p>b) kopjet e kontratave përkatëse</p> <p><u>Kërkesa 8.</u> Ofertuesi duhet ta plotësoj formularin standard për kontratat e ngjashme që ofrohet në Dosjen e tenderit.</p> <p><u>Evidenca 8.</u> Formulari i plotësuar dhe nënshkruar/vulosur me shërbimet e ngjashme të realizuara ne tri vitet e fundit (2021, 2022 dhe 2023, përfshirë 2024 deri në shpalljen e këtij tenderi), duke saktësuar shërbimet e realizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin si dëshmi për secilën prej shërbimeve.</p> <p><u>Kërkesa 9:</u> Kushtet dhe termat që zbatohen për këto shërbime.</p> <p><u>Evidenca 9:</u> Të ofrohet si dëshmi:</p> <p>a) Deklaratë zyrtare nga operatori ekonomik ku përshkruhen termat dhe kushtet për shërbimet/licencat.</p> <p>b) Kopja e dokumenteve të termave dhe kushteve të prodhuesit zyrtar të licencave, të cilat konfirmojnë zbatueshmërinë e këtyre termave.</p> <p>c) Konfirmimi i nënshkruar nga operatori ekonomik se do të respektohen termat dhe kushtet e përcaktuara nga prodhuesi për licencat e ofruara</p>
---	--

V PROCEDURA

V.1 Lloji i procedurës: Procedurë e hapur

VI. KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS: “Tenderi i përshtatshëm me çmimin më të ulët” në përputhje me nenin 28 të Rregullës së prokurimit në BQK

VII. INFORMATA ADMINISTRATIVE

<p>Kushtet për marrjen e dosjes se tenderit: Afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit: 10.12.2024, ora 12:00 në e-mail adresën: prokurimi@bqk-kos.org.</p>
<p>Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë: 10.12.2024, ora 14:00.</p>
<p>Vendi dhe afati i fundit i dorëzimit të ofertave, data: 12.12.2024, ora 14:00; në objektin e BQK-së, Zyra e Arkivit, rr. “Garibaldi” nr. 33, Prishtinë.</p>
<p>Takimi për hapjen e ofertave/tenderëve, data: 12.12.2024, ora 14:30, Objekti i BQK-së, rr.“Garibaldi” nr.33, Prishtinë.</p>
<p>Kushti i sigurimit të tenderit (ofertës): 3,000 euro (tre/mijë/euro) me vlefshmëri 90 ditë nga data e hapjes të ofertës (të dorëzohet me oferte)</p>

Kushti i sigurimi të kontratës (do të kërkohet vetëm për tenderuesin e suksesshëm të cilit i jepet kontrata): 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 30 ditëve më shumë se sa afati i kontratës
Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 90 ditë nga data e dorëzimit respektivisht e hapjes
Dokumentet me pagesë: Jo

VIII. ANKESAT

Në përputhje me “Rregullën e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (shtator 2021)”, respektivisht sipas Neni 41 “Procedura e ankesës”, çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr Garibaldi 33, 10000 Prishtinë, www.bqk-kos.org, brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa nga pala e interesuar duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivën e BQK-së brenda afatit për t’u konsideruar e vlefshme. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së.

IX. ADRESA

Rr. Garibaldi 33	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): www.bqk-kos.org	
Personi kontaktues: Divizioni i prokurimit dhe kontraktimit	E-maili: prokurimi@bqk-kos.org
Telefoni: 038 222 055/452	Fax: 038 243 763